Të shtëna me armë në Shkodër, plumbi thyen xhamin e dritares së banesës



20:22 14/12/2022

Të shtëna me armë janë regjistruar në Shkodër, ku dritarja e një banese është thyer nga plumbi i armës.

Sipas të dhënave të para të korrenspondentes së Klan News në Shkodër, Emi Kalaja, plumbi ka përfunduar në xhamin e dritares së një banesë në lagjen "Skënderbeg".

Në momentin e ngjarjes, brenda shtëpisë kanë qenë banorët. Fatmirësisht nuk ka të lënduar.

Policia thotë se nga analizimi i kamerave të sigurisë ka parë që drejtuesi i një mjeti ka qëlluar një herë në ajër me armë zjarri.

INFORMACIONI I POLICISË SË SHKODRËS:

Më datë 14.12.2022, rreth orës 20:00, një shtetas ende i paidentifikuar, duke qarkulluar me automjet, në rrugën "Hilë Mosi", në lagjen "Skënderbeg", në ecje e sipër ka qëlluar një herë, me armë zjarri, në ajër. Si pasojë predha e plumbit ka rënë në dritaren e katit të tretë të banesës së shtetasit P. S., 57 vjeç. Nga rënia e predhës nuk ka mbetur i dëmtuar asnjë person.

Grupi hetimor ka sekuestruar menjëherë pamjet e kamerave të rrugës, në të cilat dallohet drejtuesi i automjetit që ka qëlluar një herë me armë zjarri, në ajër. vijojnë veprimet, nën drejtimin e Prokurorisë, për sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorit. Shërbimet e Policisë vijojnë kontrollin e zonës dhe janë ngritur pika kontrolli, në të gjitha rrugët, me qëllim bllokimin e automjetit dhe kapjen e autorit.

/tvklan.al

TË NGJASHME

Grabitet një shumë parash në një biznes

10:13 15/12/2022

Greqi| Shqiptari hyn për të vjedhur, pronari i banesës e qëllon me pushkë

09:38 15/12/2022

Humb jetën 43-vjeçari shqiptar në Itali (Emri)

09:11 15/12/2022

Plagosje me thikë në Gramsh

08:02 15/12/2022

Të shtëna me armë në Shkodër, plumbi thyen xhamin e dritares së banesës

19:22 14/12/2022

10 vjet burg për spiunin iranian

14:45 14/12/2022

Aksidenti tragjik | Shqiptari humb kontrollin e mjetit, përplas një grua dhe vdes

13:18 14/12/2022



8 vjet e 8 muaj burg për ish-truprojën e Saimir Tahirit

10:42 14/12/2022

Kapet me 250 doza me drogë, arrestohet 30-vjeçari. Procedohet e motra e tij

09:40 14/12/2022

© 2022 TV Klan. All Rights Reserved.